



Sima Gazikalloviq ka lindur më 20 nëntor të vitit 1947. Titullin e kameramanit e ka arritur në Fakultetin e Arteve në Cyrih, drejtimi kamera për efekte speciale, të cilin fakultet e ndoqi nga viti 1973 deri 1977. Karrierën profesionale e ka filluar në vitin 1980, si kameraman në Radio Televizionin e Serbisë. 20 vite i ka kaluar duke punuar në shërbimin publik, deri në vitin 2000. Po atë vit është angazhuar në zgjidhjen e krizës në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Në atë kohë ka qenë përgjegjës për të punuar me komunitetet etnike dhe ka kryer punët lidhur me marrëdhëniet me media.

Në vitin 2001 është zgjedhur si kryetar i parë i Koalicionit për kthim në Kosovë dhe Metohi dhe bëhet bashkëpunëtor aktiv në zgjidhjen e krizave në Kosovë dhe Metohi. Në të njëjtën kohë ka qenë përgjegjës për çështjet të cilat kanë qenë të lidhura territorialisht në zgjidhjen e problemeve në pjesën e Anamoravës.

Në kohën e krizave në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës ka qenë pjesëmarrës aktiv në të gjitha bisedimet me përfaqësuesit ndërkombëtar në çështjet e zgjidhjes së krizës në këto tri komuna.

Në periudhën prej vitit 2000 deri 2008, është angazhuar vazhdimisht në zyrën e Trupit Koordinues me seli në Bujanoc.

Është i martuar dhe baba i tre fëmijëve.